

## KONTRATË

Numri i kontratës<sup>1</sup>: 632-25-6013-1-3-6/C1124

**KOMUNA E GJAKOVËS**, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; dhe

**LALITA GROUP SH.P.K.**, Lipjan, Lipjan, me numër unik 811862061, e përfaqësuar nga Besim Sllamniku (ne vazhdim "Furnizuesi"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për furnizimet e shënuara me poshtë:

**Furnizim me material për kabinete teknike shmt "Nexhmedin Nixha" Gjakovë** me numër identifikues: 632-25-6013-1-3-6 dhe numër të brendshëm 632-25-080-136.

### Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë furnizimi me material për kabinete teknike shmt "Nexhmedin Nixha" Gjakovë nga Furnizuesi, i furnizimeve në vijim:

Nr.	Grupi
2	<b>Lot II - Furnizim me material për kabinetin e makinerisë</b>

### Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor përfundim të kontratës do të jetë 1 muaj. Furnizimi duhet të fillojnë menjëherë pas marrjes së urdhëresës nga menaxheri kontratës

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë në objektin e SHMT "Nexhmidin Nixha", në Komunën e Gjakovës.

2.3 Inkotermi<sup>2</sup> i zbatueshëm do të jetë DDP (Delivery Duty Paid).

### Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës.

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

### Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimi total i furnizimeve duhet të jetë: 2,031.50 €(dymjë e tridhjetë e një euro e pesëdhjetë cent).

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës.

4.3 Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtronet ndryshimeve.

4.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

### Neni 5 Rendi i përparrësisë i dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- Kjo marrëveshje e kontratës;

<sup>1</sup> Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesanin.

<sup>2</sup> Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare;

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

#### Neni 6 Komunikimet


6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo qe në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshtësia njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" "do të shenohen në përputhje me rrëthanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsy.

6.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Furnizuesin.

#### Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Faton Gutaj
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	06.08.2025
Vula:	



#### Për Furnizuesin

Emri:	Besim Sllamniku
Pozita:	Pronar
Nënshkrimi:	
Data:	06.08.2025
Vula:	 LALITA GROUP SH.P.K. Mr. UNI 811862061 Liqja

# KUSHTET E PËRGJITHSHME

Numri i kontratës: 632-25-6013-1-3-6/C1124

## Neni 1 Përkufizimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhc të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 "Produktet" përkufizohet si të mira materialë që kanë vlerë ekonomike, duke përfshirë por pa u kufizuar në mallrat, artikujt, lëndët e para, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë të lëngshme ose të gazshme.

1.3 "Autoriteti Kontraktues" do të thotë organizata e blerjes së mallrave, siç është e quajtur Fletën mbi të Dhënat e Tendcrit.

1.4 "Furnizues" do të thotë një person fizik ose juridik që çshëtë palë c kësaj kontrate dhc sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon mallra që janë objekt i kësaj kontrate.

1.5 "Palë(t)" do të thotë nënshkruesit e kontratës.

1.6 "Inkotermet" do të thotë termat ndërkontaktojnjë mënyrën, kostot dhe tregtare që lidhen me transferimin e produkteve nga furnizuesi tek autoriteti kontraktues.

1.7 "Furnizim" do të thotë dorëzim i produkteve me cilësi, sasi dhc lloj të specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.

1.8 "Çmimi i kontratës" do të thotë çmimi që i paguhet furnizuesit siç specifikohet në formularin e kontratës, në përpunje me shtesa të tillë dhe rregullimet ose heqjet, si mund të bëhet në bazë të kontratës.

1.9 "Shërbimet pas shitjes" do të thotë shërbimet ndihmëse, si: instalimi, mirëmbajtja, riparimi i furnizimeve, sigurimi i pjesëve rezervë që i prodhon apo i distribuon furnizuesi dhe/ose detyrimë të ngashme në lidhje me furnizimet e produkteve.

1.10 "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.11 "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

## Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

## Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Furnizuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Furnizuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën osc një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përvèç në këto raste:

- a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Furnizuesit, të shumave që duhet të paguhën ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose
- b) në rast të dhënieve së të drejtës së Furnizuesit siguruesve të Furnizuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Furnizuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Furnizuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënen e kontratës përvèç në rastë kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

## Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Furnizuesi ia beson realizimin e një pjesë të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit te ofertes. Ne rast te ndryshimit te nënkontraktuesve gjate implementimit te kontrates, Furnizuesi duhet te njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Furnizuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Furnizuesi nuk

nënkontrakton pa autorizim mc shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithe nënkontraktuesit e propozuar duhet te përmbushin kërkesat e pershtatshmerise.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Furnizuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe negligencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose negligencë e Furnizuesit, agentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Furnizuesin nga obligimt e tij sipas kontratës.

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Furnizuesit, përkizazi mc furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Furnizuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhë shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

## Neni 5 Dhënia e dokumenteve

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Furnizuesit pa pagesë atëherë kur është e nevojshme, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhë dokumenteve tjera të kontratës. Furnizuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato mund të gjenden. Pas lëshimit të certifikatës së garancisë, osc pas pranimit final të saj, Furnizuesi i kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhë dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Furnizuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Furnizuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.

## Neni 6 Ndihma lidhur me rregulloret vendore

6.1 Furnizuesi mund të kérkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhëratë apo ligjet anësore të Republikës se Kosovës të cilat mund të ndikojnë te furnizuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën c kerkuar nga Furnizuesi me shpenzime të Furnizuesit.

6.2 Nëse është e nevojshme, Furnizuesi do ta lajmërojë me kohë Autoritetin kontraktues për të dhënat mbi furnizimet ashtu që Autoriteti kontraktues të mund të marrë lejet e kërkua e licencat e importit.

6.3 Autoriteti kontraktues do të vendlodë që të marrë lejet e kërkua apo licencat e importit brenda një periudhe të arsyeshme, duke marrë parasysh datat e realizimit të kontratës.

## Neni 7 Obligimet e përgjithshme të Furnizuesit

7.1 Furnizuesi duhet ta realizojë kontratën mc kujdosin dhe syçeltësinë e duhur duke përfshirë, aty ku është specifikuar, dizajnin, prodhimin, dorëzimin e furnizimit dhe kryerjen e punëve të tjera përfshirë kompensimin për ndonjë defekt në furnizime.

7.2 Furnizuesi duhet të veprojë sipas urdhrove administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Furnizuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtëj fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu eksploruar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

7.3 Furnizuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhë do të sigurojë që personeli i tij, të afërmët e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

7.4 Furnizuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhë informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

7.5 Nëse Furnizuesi është grup, përbërja e grüpuit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

## Neni 8 Prejardhja

8.1 Furnizuesi do të paraqesë një certifikatë zyrtare të prejardhjes në momentin e pranimit të përkohshëm. Nëse ky obligim nuk plotësohet, kjo do të çojë në ndërpërje të kontratës, me paralajmërim zyrtar.

## **Neni 9                    Siguria e ekzekutimit**

9.1 Furnizuesi do tē, jo mē vonë se dita e nēnshkrimit tē kontratēs, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri pōr ekzekutim tē plotē dhe tē mire tē kontratēs. Shuma e sigurisë do tē saktēsohet nē KVK. Siguria e ekzekutimit do tē ndalet nga pagesa e Autoritetit Kontraktues pēr çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit tē plotē dhe tē duhur tē obligimeve kontraktore nga ana e Furnizuesit.

9.2 Siguria e ekzekutimit tē kontratēs do tē jetë nō formën e dhënë nē pjesën IV tē kontratēs.

9.3 Pērveç asaj pjese tē specifikuar nē KVK lidhur me shërbimin pas-shitjes, siguria e ekzekutimit do tē lëshohet brenda 30 ditësh nga lëshimi i certifikatës se perkoħshme tē pranimit.

## **Neni 10                    Sigurimi**

10.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratēs duhet te jene te siguruara plotësisht me një valute lirisht te konvertueshme kundër humbjes osc dëmtimit te rastësishëm te prodhoj ose blejë, transportoj, ruaj dhe shpérndaj ne ményrën e specifikuar ne KVK.

10.2 Pa marrē parasysh obligimet e sigurimit tē Furnizuesit sipas Nenit 10.1, Furnizuesi do tē mbajë pērgjegjësi tē plotē, dhe do ta sigurojë Autoritetin kontraktues nga tē gjitha ankesat nga palēt c treta pēr dēm ndaj pronës osc lëndime personale që shkaktohen nga ekzekutimi i kontratēs nga ana e Furnizuesit, nēnkontraktuesve dhe punētorëve tē tyre.

## **Neni 11                    Programi i realizimit**

11.1 Nëse kerkohet nē KVK, Furnizuesi do tē dorëzojë një program tē realizimit tē kontratēs që do tē aprovohet nga autoriteti kontraktues. Ky program do tē pērmbajë sē paku këto:

- i) rendin sipas tē cililit Furnizuesi propozon tē realizohet kontrata, duke pērfshirë dizajnin, prodhimin, dorëzimin nē vend tē pranimit, instalimin, testimini dhe komisionimin; dhe
- ii) tē dhëna dhe informata tē tjera tē cilat mund t'i kérkojë me arsyé autoriteti kontraktues.

11.2 KVK do tē saktësojnë limitin kohor brenda tē cilil programi i realizimit duhet t'i dorëzohet pēr aprovim autoriteti kontraktues dhc afatin c fundit pēr aprovin e Autoritetit Kontraktues. Aprovimi i programit nga autoriteti kontraktues nuk e liron Furnizuesi nga obligimet e tij sipas kontratēs.

11.3 Nëse Autoriteti Kontraktues nuk arrin tc njoftoj vendimin e tij te aprovim i pērmendur ne Nenin 11.2 brenda afateve tē pērmendura ne kontrate programi i tillë i realizimit duhet te konsiderohet i aprovar me kalimin c afateve. Në qoftë se nuk ka afat te caktuar, ato do te konsiderohet te aprovuara 30 dite pas pranimit.

11.4 Asnjë ndryshim material nē program nuk mund tē bëhet pa aprovin e autoritetit kontraktues. Megjithatë, nēse progresi i realizimit tē kontratēs nuk bëhet sipas programit, autoriteti kontraktues mund ta udhëzojë Furnizuesin që ta ripunojë programin dhe ta dorëzojë programin e ripunuar pēr aprovim tc ai.

11.5 Para pranimit tē pērkohshëm tē furnizimeve, Furnizuesi duhet tē furnizoj me manualet e funksionimit dhe mirëmbajtjes sē bashku me vizatime, tē cilat do tē janë nē detaje tē tillë që do tē mundësoj Autoritetit Kontraktues operimin, mirëmbajjen, rregullimin dhe riparimin e tē gjitha pjesëve tē furnizimeve. Pērveç nëse është pērcaktuar ndryshe nē KVK, manualet dhe vizatimet do tē janë nē gjuhën e kontratēs dhc nē forma dhc numrat tē tillë tē doklaruara nē kontratë. Furnizimet nuk do tē konsiderohen tē pērfunduara me qëllim tē pranimit tē pērkohshëm deri sa manualet dhe vizatime e tillë janë furnizuar Autoritetit Kontraktues

## **Neni 12                    Marrëveshjet tatimore dhe doganore**

12.1 Duke iu nēnshtruar dispozitave tē tjera tē pērcaktuara nē KVK, Furnizuesi do tē jetë plotësisht pērgjegjës pēr pagesën e tē gjitha taksave, detyrimeve tē pullës, taksat e licencave, tarifat doganore dhe taksat tjera që lindin apo imponohen deri nē dorëzimin c Mallrave tē kontraktuara nē vendin e dorëzimit, siç është pērcaktuar nga Autoriteti Kontraktues.

## **Neni 13                    Patentat dhe licencat**

13.1 Pērveç nē rastet kur është paraparë ndryshe nē KVK, Furnizuesi do ta sigurojë autoritetin kontraktues nga tē gjitha ankesat që janë rezultat i pērdorimit tē patentave, licencave, skicave, modeleve ose markave apo emrave tregtarë siç është specifikuar nē kontratë, pērveç nēse shkelja e tillë është rezultat i veprimit sipas dizajnit osc specifikimit tē dhënë nga autoriteti kontraktues.

## **Neni 14                    Periudha e ekzekutimit tē detyrave**

14.1 Periudha c ekzekutimit tē detyrave do tē fillojë nē datën e liksuar nē pajtim me Nenit 2, pa paragjykim ndaj zgjatjeve tē periudhës tē cilat mund tē lejohen sipas Nenit 15.

14.2 Pērveç kur palēt pajtohen ndryshe, realizimi i kontratēs duhet tē fillojë jo mē vonë se 90 ditë pas njofimit tē dhënies sē kontratēs. Pas kësaj date Furnizuesi ka tē drejtë tē mos e realizojë kontratën dhe tē marrē pērfundimin e saj apo kompensimin pēr dēmin që ka pēsuar. Furnizuesit do ta humb këtë te drejtë pērveç nëse ai e ushtron atë brenda 30 ditëve

nga data e skadimit të periudhës 90 ditësh.

14.3 Nësc mundësohen periudhat e ndara të realizimit për sasi të ndara, këto periudha nuk do të mblidhen në rastet kur një Furnizues i jepen më shumë se një sasi.

### Neni 15 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

15.1 Furnizues mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nësc realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjën nga këto arsy:

- a) Autoriteti kontraktues porosit furnizime ekstra ose plotësuese;
- b) Kushte të jashtëzakonshme klimatike në vendin e autoritetit kontraktues kanë prekur instalimin apo dorëzimin e furnizimeve;
- c) Pengesa apo kushte fizike që mund të ndikojnë në dorëzimin e furnizimeve, të cilat nuk kanë mundur të parashihen në mënyrë të mjaftueshme nga një furnizues kompetent;
- d) Urdhra administrative që kanë ndikuar në datën e realizimit, përvèç atyre që janë shkaktuar prej gabimit të furnizuesit;
- e) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- f) Të gjitha suspendimet e dorëzimit dhe/ose instalimit të furnizimeve që nuk janë për shkak të gabimit të Furnizuesit;
- g) Forca madhore;
- h) Shkaqe tjera që janë përmendur në këto Kushte të përgjithshme dhe të cilat nuk janë për shkak të gabimit të Furnizuesit.

15.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Furnizues duhet ta lajmërojë autoritetin kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkcsë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përvèç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Furnizuesit dhe autoritetit kontraktues, brenda 30 ditësh i jep autoritetit kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

15.3 Brenda 30 ditësh, me njoftim me shkrim përfundimit, autoriteti kontraktues do ta lejojë këtë zgjatje të periudhës së realizimit nësc mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive osc retrospektive, ose ta informojë Furnizuesin që nuk i është dhënë e drejtë për zgjatje të periudhës.

### Neni 16 Vonesat e ekzekutimit

16.1 Nëse Furnizues me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat osc të realizojë shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuar deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

16.2 Nëse mosdorëzimi i mallrave parandalon përdorimin e zakonshëm të furnizimeve në tërsi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 16.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të kontratës

16.3 Nësc Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së kontratës ai mundet, pasi ta njoffojë me shkrim Furnizuesin:

- të konfiskojë garancinë e realizimit;
- të ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Furnizuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënen e pjesës së mbetur të furnizimeve. Furnizuesi nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Furnizuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

### Neni 17 Suspendimi

17.1 Autoriteti kontraktues mundet, me urdhër administrativ, në çfarëdo kohë ta udhëzojë Furnizuesin që të pezullojë:

- a. prodhimin e furnizimeve;
- b. dorëzimin e furnizimeve në vendin e pranimit në kohën e specifikuar për dorëzim në programin e realizimit ose, nëse nuk është specifikuar koha, në kohën kur ato duhet të dorëzohen; ose
- c. instalimin e furnizimeve që janë dorëzuar në vendin e pranimit.

17.2 Gjatë pezullimit, Furnizuesi do të mbrojnë dhe sigurojnë furnizimet e vendosura në depon e Furnizuesit ose në ndonjë vend tjetër, nga përkqësimi, humbja apo dëmtimi për aq sa të jetë e mundur dhe sa është kërkuar nga autoriteti kontraktues, edhe nësc furnizimet janë dorëzuar në vendin e pranimit në pajtim me kontratën, por instalimi i tyre është pezulluar nga autoriteti kontraktues.

17.3 Shpenzimet plotësuese që janë shfaqur në lidhje me këto masa mbrojtëse do t'i shtohen çmimit të kontratës. Furnizuesi nuk do të marrë pagosë të shpenzimeve plotësuese nëse pezullimi është:

- Zgjidhur në mënyrë të ndryshme në kontratë; ose
- është i nevojshëm për arsyet e kushteve të zakonshme klimatike në vendin e pranimit;
- është i nevojshëm për shkak të ndonjë gabimi të Furnizuesit; ose
- është i nevojshëm për siguri të ekzekutimit të mirë të kontratës ose të ndonjë pjesë të saj përderisa nevoja e tillë nuk shkaktohet nga ndonjë veprim apo gabim nga autoriteti kontraktues.

17.4 Furnizuesi nuk do të ketë të drejtë për shtesa në çmimin e kontratës përvëç nëse ai e lajmëron autoritetin kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit për të përzulluar progresin e dorëzimit se ka për qëllim të bëjë ankesë për ta.

17.5 Autoriteti kontraktues, pas konsultimit me Furnizuesin, do të përcaktojë ato pagesa plotësuese dhe/ose zgjatje të periudhës së realizimit që do të bëhen nga Furnizuesi përkizazi me këtë ankesë në mënyrë të drejtë dhc të arsyeshme sipas mendimit të autoritetit kontraktues.

17.6 Nëse periudha e pezullimit i tejkalon 180 ditë, dhe pezullimi nuk është për shkak të gabimit të Furnizuesit, Furnizuesi, duke njoftuar autoritetin kontraktues, mund të kërkojë të vazhdojë me furnizimet brenda 30 ditësh, ose të ndërpresë kontratën.

17.7 Në rastet kur procedura e dhënies ose realizimit të kontratës bëhet e pavlefshme për shkak të gabimeve përmbytjeve, parregullisive osc mashtimit, Autoriteti kontraktues do ta pezullojë realizimin e kontratës. Në rastet kur ato gabime, parregullsi ose mashtime i atribuohen Furnizuesit, atëherë Autoriteti kontraktues mund të refuzojë t'i bëjë pagesat ose mund t'i kthejë shumat që tashmë janë paguar, në proporcione me rëndësinë e gabimeve, parregullisive osc mashtimit.

17.8 Qëllimi i pezullimit të kontratës është që të verifikohet nëse gabimet përbajtjesore të supozuara si dhe parregullsitë apo mashtimet kanë ndodhur në të vërtetë. Nëse ato nuk mund të konfirmohen, realizimi i kontratës do të rifillojë sa më shpejt që çshicë c mundur. Gabimet përbajtjesore ose parregullsitë do të jenë të gjitha shkelje të kontratës ose dispozitave rregullative që rezultojnë nga një veprim osc mosveprim që shkakton ose që mund të shkaktojë humbje në buxhetin e Autoritetit Kontraktues.

## Neni 18 Cilësia e furnizimeve

18.1 Furnizimet duhet t'i plotësojnë specifikit teknike të paraqitura në kontratë në të gjitha aspektet dhc të jenë konform në të gjitha aspektet me skicat, sondazhet, modelet, mostrat, strukturat dhe kërkesat tjera në kontratë, të cilat duhet të mbahen në dispozicion të Autoritetit kontraktues për qëllime identifikimi gjatë periudhës së realizimit të kontratës.

18.2 Të gjitha pranimet teknike preliminare të parapara në KVK duhet të bëhen me kërkesë të dërguar nga furnizuesi i për autoritetin kontraktues. Në kërkesë do të saktësohen materialet, artikujt dhc mostrat e dorëzuara për këtë pranim sipas kontratës dhc të tregojë numrin e sasisë dhe vendin ku do të bëhet pranimi në mënyrën e duhur. Materialet, artikujt dhc mostrat e specifikuara në kërkesë duhet të certifikohen nga autoriteti kontraktues se plotësojnë kërkesat për këtë pranim para se të inkorporohen në furnizime.

18.3 Edhe nëse materialet apo artikujt që do të inkorporohen në furnizime osc në prodhim të komponentëve që do të furnizohen janë pranuar teknikisht në këtë mënyrë, ato prapë mund të refuzohen nëse ndonjë kontrollim tjetër zbulon defekte ose gabime, dhe në këtë rast ato duhet të ndërrohen menjëherë nga furnizuesi. Furnizuesi mund t'i jepet mundësia t'i riparojë dhc t'i përmirësojë materialet dhe artikujt që janë refuzuar, por këto materiale dhe artikujt do të pranohen për inkorporim në furnizime vetëm nëse janë riparuar dhe janë përmirësuar në atë mënyrë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

## Neni 19 Inspektimi dhe testimi

19. Furnizuesi do të sigurojë që furnizimet të dorëzohen në vendin e pranimit me kohë që t'i mundësohet autoritetit kontraktues të vazhdojë me pranimin e furnizimeve. Furnizuesi konsiderohet se i ka paraparë plotësisht vështirësitet që mund t'i hasë në këtë aspekt, dhc atij nuk do t'i lejohet që të paraqesë ndonjë arsyet përvonesë.

19.2 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhc sasinë e kërkuar. Kjo do të bëhet në vendin e prodhimit, fabrikimit, përgatitjes ose në vendin e pranimit apo në vendet që janë specifikuara në KVK.

19.3 Për qëllime të testimeve dhe inspektimeve të tilla, Furnizuesi do të:

- I japë autoritetit kontraktues, përkohësisht dhc pa pagesë, ndihmë, mostra osc pjesë për testim, makina, pajisje, vegla, punë, materiale, skica dhe të dhëna të prodhimit që zakonisht kërkohen për inspektim dhe testim;
- Të merret vesh me autoritetin kontraktues për vendin dhe kohën e testimeve;
- T'i japë autoritetit kontraktues qasje në çfarëdo kohe të arsyeshme në vendin ku do të realizohen testimet.

19.4 Nëse përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktues nuk është prezent në datën e vendosur për testim, furnizuesi mundet që, përvëç nëse ka marrë udhëzim tjetër nga autoriteti kontraktues, të vazhdojë testimin, i cili do të konsidrohet se është bëre në prezencën e autoritetit kontraktues. Furnizuesi menjëherë do t'i dërgojë kopjet e certifikuarë si duhet të rezultateve të

testit te Autoriteti kontraktues, nese nuk ka qenë prezent gjatë testit, do t'i pranojë rezultatet e testit.

19.5 Nëse komponentët dhc materialet i kanë kaluar testet e sipërpermendura, autoriteti kontraktues do ta lajmërojë furnizuesin ose ta miratojë certifikimin e furnizuesit lidhur me këtë.

19.6 Nëse autoriteti kontraktues dhc Furnizues nuk pajtohen për rezultatet e testit, secili do t'ia japë tjetrit mendimin e vet brenda 15 ditësh nga mospajtimi i tillë. Autoriteti kontraktues osc Furnizues mund të kërkojnë që këto teste të përsëriten në të njëjtat kushte dhe rrëthana, osc nesc ndonjëra palë kërkon, të testohen nga një ekspert i zgjedhur me marrëveshje të ndërsjellë. Të gjitha raportet e testimt do t'i dorëzohen autoritetit kontraktues, i cili do t'i komunikojë rezultatet e këtyre testeve pa vonesë te furnizuesi. Rezultatet e ri-testimit do të janë përfundimtare. Kostoja e ri-testimit do të bartet nga pala pikëpamja e së cilës dëshmohet se është gabim pas ri-testimit.

19.7 Gjatë realizimit të detyrvave të tyrc, autoriteti kontraktues dhe personat e autorizuar nga ai nuk do t'i shpalosin personave të paautorizuar informata lidhur me metodat e ndërmarrjes së prodhimit dhe operimit, të cilat informata i kanë marrë gjatë inspekçimit dhe testimt.

## Neni 20 Parimet të përgjithshme të pagesave

20.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Metoda dhe kushtet e pagesës që duhet t'i bchet Furnizues sipas kësaj Kontrate do te specifikohen ne KVK.

20.2 Pagesat qe duhet te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Furnizues do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, Identifikimi Financiar, i kësaj kontrate që e plotëson Furnizuesi. i njëjti formular, që i bashkëngitet kërkesës për pagosë, duhet të përdoret pér t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

20.3 Shumat duhet të paguhën brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshmë pér pagosë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa pér pagesë nuk do të jetë e pranueshme nese nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

20.4 Periudha prej 30-ditësh mund të përzullohet duke e lajmëruar Furnizuesin që kërkesa pér pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet pér shak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përbajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm pér qëllim të kontrollimeve tjera. Furnizues do të jepë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa pér pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

20.5 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 20.3, Furnizues mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin pér pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zhatohet nga institucioni lëshues i Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi pér pagesë të vonuar do të zhatohet pér kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhc datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

20.6 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 20.3 do t'i japin të drejtë Furnizuesit që ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh pér Autoritetin kontraktues.

## Neni 21 Dorëzimi

21.1 Furnizues duhet t'i dorëzojë furnizimet në pajtim me kushtet e kontratës. Furnizimet do të janë në përgjegjësi të Furnizuesit deri në pranimin e tyre të përkohshëm.

21.2 Furnizuesi do t'i paketojë furnizimet ashtu siç kërkohet pér të parandaluar dëmtimin apo kçqësimin e gjendjes së tyre gjatë transportit deri në destinacionin e tyre, siç është dhënë në kontratë. Paketimi duhet të jetë i mjafshëm pér të përballuar pa kufizime, bartjen e ashpër, eksposimin në temperaturat ekstreme, kripën dhe rëniet gjatë tranzitit dhc mbajtjen në ambient të hapur. Madhësia e paketimit dhe pesha duhet t'i përshtaten, nesc është e mundur, largësisë së destinacionit përfundimtar të furnizimeve, dhc mundësia së mungesës së pajisjeve pér bartje të rendë në të gjitha pikat gjatë transitit.

21.3 Paketimi, shënim i dñe dokumentacioni brenda dhc jashtë pakove duhet të janë në pajtim me kërkesat e dhëna nç mënyrë të hapur në KVK, dhc i nënshtrohen ndryshimeve që mund të urdhërohen më vonë nga autoriteti kontraktues.

21.4 Asnjë furnizim nuk do të transportohet as të dorëzohet në vendin e pranimit derisa furnizuesi të ketë pranuar urdhrrin e dorëzimit nga autoriteti kontraktues. Furnizuesi do të jetë përgjegjës pér dorëzim në vendin e pranimit të të gjitha furnizimeve dhe pajisjeve të furnizuesit, që janë të nevojshme pér qëllime të kontratës.

21.5 Dorëzimi duhet të konsiderohet se është bërë atëherë kur ka dëshmi me shkrim që është në dispozicion pér të dy palët se dorëzimi i furnizimeve është bërë në pajtim me kushtet e kontratës.

## Neni 22 Operacionet e verifikimit

22.1 Furnizimet nuk do të pranohen derisa të jenë realizuar verifikimet dhe testet e caktuara me shpenzime të Furnizuesit. Inspektimet dhe testet mund të realizohen para transportit, në pikën e dorëzimit dhe/ose në destinimin final të mallrave.

22.2 Autoriteti kontraktues, gjatë progresit të dorëzimit të furnizimeve dhc para se të merren furnizimet, duhet të ketë fuqinë që të urdhërojë ose të vendosë:

- a) heqjen nga vendi i pranimit, brenda asaj kohe ose kohësh siç është specifikuar në urdhër, të të gjitha furnizimeve të cilat, sipas mendimit të autoritetit kontraktues, nuk janë në pajtim me kontratën;
- b) zëvendësimin e tyre me furnizime të mira dhc të përshtatshme;
- c) heqjen dhe ri-instalimin e mirë të pajisjeve, pa marrë parasysh testet e mëparshme të tyre ose pagesat e pjeshtës së shpenzimeve të tyre, osc ndonjë instalim që lidhet me materialt, mjeshtërinë ose dizajnin për të cilin është përgjegjës furnizuesi, e që sipas mendimit të autoritetit kontraktues nuk është në pajtim me kontratën;
- d) që puna e bërë ose mallrat e dorëzua apo materialet e përdorura nga furnizuesi janë ose nuk janë në pajtim me kontratën, ose që furnizimet apo një pjesë e tyre nuk i plotësojnë kërkesat e kontratës.

22.3 Furnizuesi, sa më shpejt që është e mundur dhe me shpenzime të veta, duhet t'i evitojë defektet e specifikuara. Nëse Furnizuesi nuk vepron sipas këtyre urdhërave, Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të punësojë persona tjerë për t'i zbatuar urdhrat dhe të gjitha shpenzimet që janë pasojë e kësaj, apo që do të shfaqen për shkak të kësaj, Autoriteti kontraktues do t'i zbresë nga paratë që do të paguhen ose të cilat do të bëhen obligim për t'iu paguar Furnizucusit.

22.4 Furnizimet që nuk janë të cilësisë së kërkuar do të refuzohen. Një shenjë speciale mund t'u vendoset furnizimeve të refuzuara. Shenja nuk duhet të jetë e atillë që t'i ndryshojë ato, apo të ndikojë në vlerën e tyre komerciale. Furnizimet e refuzuara furnizuesi do t'i heqë nga vendi i pranimit, nëse këtë e kërkon autoriteti kontraktues, brenda një periudhe që e saktëson autoritetit kontraktues, dhe nëse kjo nuk realizohet ato do të hiqen mc të drejtë mc shpenzim dhe me rrezik të furnizuesit. Të gjitha punët që përfshijnë materialt e refuzuara do të refuzohen.

### Neni 23 Pranimi i përkohshëm

23.1 Furnizimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të janë dorëzuar në pajtim me kontratën, t'i kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet e kërkuar, dhe të janë autorizuar, si dhe të jetë lëshuar një certifikatë e pranimit të përkohshëm ose nëse konsiderohet si është lëshuar.

23.2 Furnizuesi mund të bëjë kërkesë, duke lajmëruar autoritetin kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm atëherë kur furnizimet të janë të gatshinc për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga pranimi i aplikacionit të furnizuesit do të veprojë sipas njërsë nga këto më poshtë:

- t'i lëshojë furnizuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, cdhc datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar furnizimet në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; osc
- të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij e kërkon Furnizuesi për ta lëshuar certifikatën.

23.3 Nëse rrethanat e jashtëzakonshme e bëjnë të pamundur që të vazhdohet me pranimin e furnizimeve gjatë periudhës së fiksuar për pranim të përkohshëm ose final, autoriteti kontraktues e përgatit një deklaratë për ta vërtetuar pamundësinë e tillë, nëse është e mundur, në konsultim me furnizuesin. Certifikata e pranimit osc e refuzimit do të përgatitet brenda 30 ditësh pas datës në të cilën kjo pamundësi pushon së ekzistuari. Furnizuesi nuk do të nxisë shfaqjen e këtyre rrethanave për të evitar obligimin e paraqitjes së furnizimeve në një gjendje të përshtatshme për pranim.

23.4 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose t'i lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej [30] ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe, përveç në rastet kur certifikata e pranimit të përkohshëm konsiderohet se përbën certifikatë të pranimit përfundimtar. Nëse furnizimet ndahen me kontratë në pjesë, Furnizuesi do të ketë të drejtë të bëjë kërkesë për certifikatë të veçantë për secilën pjesë.

23.5 Në raste të dorëzimit të pënjeshëm, Autoriteti kontraktues rezervon të drejtën për të dhënë pranim të pënjeshëm e të përkohshëm.

23.6 Pas pranimit të përkohshëm të furnizimeve, Furnizuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkufizuar me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

### Neni 24 Obligimet për garanci

24.1 Furnizuesi do të garantojë që furnizimet të janë të reja, të papërdorura, të modeleve të fundit dhe të përfshijë të gjitha përmirësimet e kohëve të fundit në dizajn dhe materiale, përveç nëse kërkohet ndryshe në kontratë. Furnizuesi do të garantojë që asnjë nga furnizimet të mos kenë defekt që shkaktohet nga dizajni, materialet apo mjeshtëria. Kjo garanci do të mbetet e vlefshme në atë mënyrë që saktësohet në KVK.

24.2 Furnizuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, osc dëmeve në ndonjë pjesë të furnizimeve të cilat mund të paraqiten, apo të ndodhin gjatë periudhës së garancisë dhe të cilat:

- a) rezultojnë nga përdorimi i materialeve defektive, mjeshtërisë së gabueshme ose dizajnit jo të mirë nga Furnizuesi; osc
- b) rezultojnë nga veprimet ose mosveprimet e Furnizucusit gjatë periudhës së garancisë; osc
- c) shfaqen gjatë ndonjë inspektimi të bërë nga Autoriteti kontraktues ose në emër të tij.

24.3 Furnizuesi mc shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin osc dëmin sa më shpejt që kjo të mund të praktikohet. Periudha e garancisë për të gjithë artikujt e ndërruar ose të riparuar do të fillojë përsëri nga data në të cilën është bërë

ndërrimi osc riparimi sipas vlerësimit të autoritetit kontraktues. periudha e garancisë do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të furnizimeve që është ndikuar nga ndërrimi apo riparimi.

24.4 Nëse shfaqet ndonjë defekt osc ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së garancisë, autoriteti kontraktues do ta lajmërojë k Furnizuesin. Nëse Furnizuesi nuk arrin ta kompensojë dëmin nga ndonjë defekt ose një dëm brenda afatit kohor të paraparë në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- të korigjojë defektin apo dëmin vetë, ose të punësojë dikë tjetër për ta bërë punën në rrezikun dhe me shpenzimet e Furnizuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga paratë që duhet të paguhen ose garancitë që mbahen prej Furnizuesit osc nga të dy;
- në rast se nuk ka sasi të duhur osc asnjë garanci nuk është efektive kërkoni që të merrni shumën e duhur nga Furnizuesi; osc
- të ndërpresë kontratën.

24.5 Obligimet e mirëmbajtjes do të parashihen në KVK dhe në specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së garancisë nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e garancisë do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

## Neni 25 Shërbimet pas-shitjes

25.1 Shërbimet pas-shitjes, nesc kërkohen në konratë, do të jepen në pajtim me të dhënat e parapara në KVK. Furnizuesi do të marrë përsipër të realizojë ose të organizojë realizimin e mirëmbajtjes dhe të riparimit të furnizimeve dhe të sigurojë shpejt pjesët rezervë. KVK mund të saktësojnë që Furnizuesi të sigurojë ndonjë osc të gjitha materialet e mëposhtme, njoftimet dhe dokumentet që kanë të bëjnë me pjesët rezervë që i prodhon apo i distribuon Furnizuesi:

- pjesët rezervë të cilat Autoriteti kontraktues mund të vendosë t'i blejë nga Furnizuesi, duke kuptuar që ky vendim nuk do ta lirojë Furnizuesin nga obligimet e garancisë sipas kontratës
- në rast të ndërpërjes së prodhimit të pjesëve rezervë, duhet të lajmërohet paraprakisht Autoriteti kontraktues për t'i mundësuar që të blejë pjesët e këruara dhc, pas ndërpërjes, skicat, vizatimet dhe specifikimet e pjesëve rezervë, nese kërkohen dhe kur kërkohen do t'i sigurohen Autoriteti kontraktues pa pagesë.

## Neni 26 Pranimi përfundimtar

26.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të janë zgjidhur të gjitha defektit apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Furnizuesit një certifikatë të pranimit përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Furnizuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata finale e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë këruar sipas Nenit 24 të janë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

26.2 Kontrata nuk do të konsiderohet se është realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit ose derisa të konsiderohet se kjo është nënshkruar nga autoriteti kontraktues.

26.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Furnizuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të paraleluara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhc masa e obligimeve të tillë do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

## Neni 27 Shkelja e kontratës

27.1 Pala ka shkelë kontratën nese nuk arrin të shlycjtë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

27.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- dëmet; dhc/osc
- ndërpërjen e kontratës.

27.3 Përvoç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërbime. Ato mund të janë:

- dëme të përgjithshme; ose
- dëme të likuidueshme.

27.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Furnizuesit, nga depozita, osc me pagesë nga siguria.

## Neni 28 Ndërpërja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

28.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Furnizuesit 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- kur Furnizuesi në mënyrë përmbytjesore nuk arrin t'i realizojë obligimet e veta sipas kësaj kontrate;

- b) Furnizuesi dështon në përbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të punëve;
- c) Furnizuesi refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhërave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- d) Furnizuesi ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- e) Furnizuesi falimenton osc është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pozulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, osc është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregullorët nationale;
- f) Furnizuesi është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- g) Furnizuesi është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;
- h) Furnizuesi i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korruption, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjeter ilegal që i dëmton interesat financiare të Komuniteteve;
- i) Furnizuesi, pas një procedure tjeter të prokurimit ose procedure të dhënies së një granti të financuar nga buxheti i komunitetit, është deklaruar se ka bërë shkelje serioze të kontratës për mosrealizim të obligimeve të veta kontraktuese;
- j) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Furnizuesit, përvçë nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;
- k) shfaqet ndonjë paaftësi tjeter ligjore që i pengon realizimin të kontratës;
- l) Furnizuesi nuk arrin të jep garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që c jep garancinë apo sigurimin më të hershem të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

28.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhc Furnizuesit sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkratë ndonjë kontratë tjeter me një palë të tretë në emër të Furnizuesit. Detyrimi i Furnizuesit për të shtyrë përbushjen duhet të pushojë së ekzistuar menjëherë pas ndërprerjes, pavarësisht nga detyrimet që mund të jenë paraqitura tashmë.

28.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njofimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Furnizuesin që të ndërmarrë hapë të menjëherëshëm për ta përbyllur ekzekutimin e furnizimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhc për t'i zgjedhur në minimum shpenzimet.

28.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Furnizuesit ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi furnizimet e dorëzuara dhe punës së realizuar dhe të bëjë rexhistrimin e materialeve të furnizuara dhe të papërdorura. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhen Furnizuesit dhe parave që i ka borxh Furnizuesit Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

28.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Furnizuesin derisa të janë përfunduar furnizimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Furnizuesi koston ekstra, nëse ka, të furnizimeve ose do të paguajë shumë që duhet t'i paguhet Furnizuesit para ndërprerjes së kontratës.

28.6 Nëse Autoriteti kontraktues c ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Furnizuesi humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës të parapara në Nenin 2 të KVK.

## Neni 29 Ndërprerja nga ana e Furnizuesit

29.1 Furnizuesi, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues:

- nuk arrin t'i paguajë Furnizuesit shumat që duhet t'i paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit.
- vazhdimeshit nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- e pozullon dorëzimin e furnizimeve, ose ndonjë pjesë të tyre, për më tepër se 180 ditë, për arsy që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk mund t'i atribuohen Furnizuesit.

29.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjeter sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit.

29.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) te Sessonit 29.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Furnizuesin për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Furnizuesit.

## Neni 30 Forca madhore

30.1 Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë mosrespektim ose shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi

i obligimeve tē tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një *force madhore* që shkaktohet pas datës kur kontrata hyn në fuqi.

30.2 Për qëllime tē këtij Neni, termi "force madhore" do tē thotë veprimet e zotit, godijet, mbylljet e objektit ose çrrëgullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin tē deklaruara ose jo, blokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitet, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtëngatat, vërtëtima, vërvshimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjeter e ngjashme e paparashikuar që është përtëj kontrollit tē palëvc dhe nuk mund tē përballohet as me kujdesin e duhur.

30.3 Pa marrë parasysh dispozitat e Neneve 16 dhc 28, Furnizuesi nuk do tē jetë i detyruar tē heqë dorë nga garancia e realizimit, dëmet e likuiduara osc ndërprerja për shkak tē shkoljes nëse, dhe deri në atë masë sa, vonesa e tij e realizimit ose mënyrë tjeter dështimi për tē realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje tē forcës madhore. Gjithashtu, pa marrë parasysh dispozitat e Neneve 20.5 dhc 29, Autoriteti kontraktues nuk do tē jetë i detyruar tē paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nga Furnizuesi pér shkelje tē kontratës, nëse dhe deri në atë masë sa vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjeter i dështimit për tē kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

30.4 Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrëthanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund tē ndikojë në realizimin e obligimeve tē saj, menjçherë do ta lajmërojë palën tjeter, duke dhënë tē dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrëthanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga autoriteti kontraktues me shkrim, Furnizuesi do tē vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe tē angazhojë tē gjitha mjetet e arsyeshme alternative për tē plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore tē mos e pengojë atë gjatë punës. Furnizuesi nuk do tē zhatojë mjete tē tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga autoriteti kontraktues

30.5 Nëse Furnizuesi shkakton kosto plotësuese gjatë zbatimit tē urdhavrave tē autoritetit kontraktues ose gjatë përdorimit tē mjeteve alternative sipas nenit 30.4 shuma e saj do tē certifikohet nga autoriteti kontraktues.

### Neni 31 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

31.1 Palët duhet t'i bëjnë tē gjitha përpjekte për tē zgjidhur në mënyrë miqësore tē gjitha mosmarrëveshjet që mund tē ndodhin ndërmjet tyre. Sapo tē shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën mc shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë sc është e mundshme. Nëse cilado palë e shesh tē dobishme, palët do tē takohen dhe tē mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do tē i përgjigjet kërkесës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkësës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do tē jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për tē arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon tē përgjigjet me kohë ndaj kërkësave për zgjidhje, të dyja palët do tē jenë tē lira tē vazhdojnë në fazën e ardhshme tē procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

31.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore tē mosmarrëveshjes dështon, palët mund tē merren vesh tē përpiken tē pajtohen përmes institucionit tē specifikuar në KVK. Nëse nuk mund tē arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh pas fillimit tē procedurës së pajtimit, secila palë do tē ketë tē drejtë tē vazhdojë në fazën e ardhshme tē procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes

### Neni 32 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

32.1 Nëse nuk mund tē arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje tē mosmarrëveshjes, secila palë mund tē kërkojë:

- ose vendim nga gjyqi; ose
- kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim mc KVK..

32.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

# KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 632-25-6013-1-3-6/C1124

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridikioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë shqipe.
Siguria e ekzekutimit	9.1	N/A
Sigurimi	10.1	DDP <sup>3</sup> (Dërgesat e Detyrës të Paguara).
Programi i ekzekutimit	11	N/A
Tatimet dhe marrëveshjet doganore	12.1	Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.
Patentat dhe licencat	13.1	N/A
Cilësia e furnizimeve	18.2	Autoriteti Kontraktues do të refuzoje çdo dergese te materialit i cili deshton ne perm bushjen e specifikimeve minimale te cilesise te perçaktuara ne specifikimin teknik.
Inspektimi dhe testimi	19.2	Inspektimi dhe testimi do te kryhen me rastin e dorëzimit dhe ne përputhje me Nenin 19 te Kushteve te Përgjithshme ne adresat e specifikuara ne Nenin 2.2 te Kontratës.  Menaxheri i Projektit dhe Komisioni për pranimin e furnizimeve do të caktohet me vendim të ZKA.
Pagesa	20.1	Pagesa do të bëhet nga ana e Autoritetit Kontraktues për furnizimet e dorëzuara vetëm në bazë të shumës së vlerës së një Urdhër Blerje te vlefshme të lëshuar nga Autoriteti kontraktues.
Dorëzimi	21.3	Furnizuesi do t'i bartë të gjitha rreziqet që kanë të bëjnë me mallrat deri në pranimin në destinacion. Furnizimet duhet të paketohen në mënyrë që të parandalohet dëmtimi i tyre deri në destinacionin e tyre.  <b>Dërgesa:</b> Dërgesat do të bëhen brenda 1 muaji, pas marrjes se urdhëresës nga projekt menaxheri, kontratës .  Dorëzimi do të bëhet në një ditë pune dhe gjatë orarit të punës të Autoritetit kontraktues (e hënë - e premte, 8:00-16:00).
Obligimet e garacionit	24.1	N/A

<sup>17</sup> DDP – Dërgesat e Detyrës të Paguara – Incoterms 2010 Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.


	24.5	N/A
Shërbimet pas shitjes	25.1	N/A
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	31.2	<b>Komisioni për ndërmjetësim pranë Ministrisë se Drejtësisë</b>
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	32.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <b>Gjykatën Themelore-Prishtinë</b> në pajtim me ligjin në Kosovë.

Furnizimi me material per kabinete teknike SHMT "Nexhmedin Nixha" GJAKOVË

Lot II - Kabinet - Makinerisë

Nr.	Përshtirimi	Madhësia	Njësia Matëse	Sasia	Cmimi njësi me TVSH	Cmimi total me TVSH
1	Celce te pa garantuar C0363 (SI 37-3). Shifte e plotë	fl. 40- mm x 4m	kg	90	8.20	558.00
2	Celce te pa garantuar C0363 (SI 37-3). Shifte e plotë	fl. 5- mm x 24 m	kg	5	3.00	15.00
3	Celce te pa garantuar C0363 (SI 37-3). Shifte e plotë	fl. 6- mm x 24 m	kg	5	1.00	5.00
4	Celce te pa garantuar C0363 (SI 37-3). Shifte e plotë	fl. 10- mm x 24 m	kg	14	7.00	98.00
5	Celce te pa garantuar C0363 (SI 37-3). Shifte e plotë	fl. 12- mm x 24 m	kg	21	3.00	63.00
6	Profil kallore te celikut pa garantuar C0363 (SI 37-3)	40x40x2mmx6m	kg	50	3.00	150.00
7	Profil kallore te celikut pa garantuar C0363 (SI 37-3)	28x20x2mmx6m	kg	25	3.30	82.50
8	Disk per përmje hequr	230x1.9x22.2 mm	copë	10	1.00	10.00
9	Disk per përmje hequr	115x1.0x22.2 mm	copë	10	0.80	8.00
10	Profil gyp te celikut pa garantuar C0363 (SI 37-3)	fl. 22-mm x1.8-mm	kg	40	3.50	140.00
11	Profil gyp te celikut pa garantuar C0363 (SI 37-3)	fl.27-mm x 2-mm	kg	50	3.30	99.00
12	Thika vjezë per vrimë	R 12.12	copë	10	5.00	50.00
13	Thika vjezë per vrimë	R 10.10	copë	10	5.00	50.00
14	Thika vjezë per vrimë	R 8.8	copë	10	5.00	50.00
15	Thika vjezë per lijet te mbrendshme	R 12.12	copë	10	4.00	40.00
16	Thika vjezë per lijet te mbrendshme	R 10.10	copë	10	6.00	60.00
17	Thika vjezë per prerje	R 18.10	copë	10	5.00	50.00
18	Thika vjezë per prerje	R 12.12	copë	10	3.50	35.00
19	Thika vjezë per shembje te diatrizë	R 16.16	copë	10	5.00	50.00
20	Burgje	F 6	copë	10	1.00	10.00
21	Burgje	F 8	copë	10	1.00	10.00
22	Burgje	F 10	copë	10	1.00	10.00
23	Burgje	F 14	copë	5	1.00	5.00
24	Burgje	F 12	copë	10	2.00	20.00
25	Burgje fiksuese per hapje te mbetje te midhëndëshme 3 copë	M 8	komplet	4	8.00	32.00
26	Burgje fiksuese per hapje te mbetje te midhëndëshme 3 copë	M 8	komplet	4	8.00	32.00
27	Burgje fiksuese per hapje te mbetje te midhëndëshme 3 copë	M 8	komplet	4	5.00	20.00
28	Burgje fiksuese per hapje te mbetje te midhëndëshme 3 copë	M 10	komplet	4	6.00	24.00
29	Burgje fiksuese per hapje te mbetje te midhëndëshme 3 copë	M 12	komplet	2	10.00	20.00
30	Burgje fiksuese per hapje te mbetje te midhëndëshme 3 copë	M 14	komplet	2	2.00	4.00
31	Burgje fiksuese per hapje te mbetje te midhëndëshme 3 copë	M 16	komplet	2	3.00	6.00
32	Madravide per hapje te mbetje te jashtme	M 8	copë	4	5.00	20.00
33	Madravide per hapje te mbetje te jashtme	M 8	copë	4	3.00	12.00
34	Madravide per hapje te mbetje te jashtme	M 8	copë	4	1.00	4.00
35	Madravide per hapje te mbetje te jashtme	M 10	copë	2	1.00	4.00
36	Madravide per hapje te mbetje te jashtme	M 12	copë	2	1.00	2.00
37	Madravide per hapje te mbetje te jashtme	M 14	copë	2	1.00	2.00
38	Madravide per hapje te mbetje te jashtme	M 16	copë	2	10.00	20.00
39	Norius	16mm	copë	4	10.00	40.00
40	Norius	200mm	copë	2	10.00	20.00
41	Emissor lang parabolik	/	lira	5	3.00	15.00
42	Thika vjezë perfiltë te jashtme	R 16.16	copë	10	5.00	50.00
Gjithsej totali me TVSH					2.031.50	

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1. E.D.K. -   
2. M.T. -   
3. S.S.H. - 

B. S. /kmm/nivo

LALITA GROUP SH.P.K.

## PJESA V E KONTRATËS: IDENTIFIKIMI FINANCIAR

MBAJTËSI I LLOGARISË	
Emri	LACITA GILOUR SH, P.A.
Adresa	RR: Shqipëria
Qyteti	LIPJAN
Kodi Postar	14000
Kontakti	Besim Sllamxhiu
Telefoni	0431 850 128
Fax	
E-mail	laci6agroup2@gmail.com
Numri i TVSH	330491134

BANKA	
<b>Emri</b>	TERESA
<b>Adresa</b>	ACIM RAMADANI NR. 45.
<b>Qyteti</b>	RRISTINA
<b>Kodi Postar</b>	10-000
<b>Shteti</b>	KOSOVO
<b>Llogaria Bankare</b>	
<b>BAN (opcionale)</b>	
<b>BIC (Opcionale)</b>	

SHĒNIME:

**VULA E BANKËS + NËNSHKRIMI I  
PËRFAQËSUESIT TË BANKËS (Të  
dyja të obligueshme)**

The stamp is circular with the following text:  
DATA + NËNSHKRIMI i MBAJTËSIT  
TË LLOGARISË: (e obligueshme)  
06.8.2023  
B. KOMBI  
LIPJAN-KC